

SYLLABUS

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike	Fakulteti i Arkitekturës, Dizajnit dhe Teknologjisë së Drurit
Programi	Arkitekturë e Interierit dhe Dizajni i Mobilieve
Titulli i lëndës	Menaxhimi i projekteve
Niveli	Bachelor
Statusi i lëndës	Obligative
Viti i studimeve	III
Semestri	VI
Numri orëve në javë	3
Vlera në kredi - ECTS	4
Koha / lokacioni	USHAF
Mësimdhënësi i lëndës	Prof. Asoc. Dr. Sokol Krasniqi
Detajet kontaktuese	sokol.krasniqi@ushaf.net
Përshkrimi i lëndës	Lënda Menaxhimi i Projekteve ofron një hyrje gjithëpërfshirëse në parimet, proceset dhe praktikatat e menaxhimit të projekteve, me fokus të veçantë në planifikimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e projekteve në një kontekst organizativ. Studentët do të mësojnë si të përcaktojnë objektivat e projektit, të hartojnë planin e projektit, të menaxhojnë resurset dhe rreziqet, si dhe të ndjekin dhe vlerësojnë ecurinë e projektit për të arritur suksesin e tij. Lënda kombinon teorinë me praktikatat më të mira dhe përfshin ushtrime praktike, analiza rastesh dhe përdorim të softuerëve bashkëkohorë për menaxhimin e projekteve (si MS Project, etj.), duke përgatitur studentët për sfidat reale të tregut të punës.
Qëllimet e lëndës	Ofrimi i njohurive bazike për menaxhimin e projekteve, studenti fiton aftësi të mjaftueshme për të menaxhuar me projekte të ndryshme në industri, gjatë fazës së krijimit të idesë së konceptit, pastaj mbi kriteret e përzgjedhjes së projektit, organizimin e projektit, fazën e implementimit, fazën e kontrollit dhe përfundimin e projektit.

Rezultatet e pritura të mësimnxënies	Pas përfundimit të kësaj lënde, studenti do të jetë në gjendje të:		
	R1. Përfitojë njohuri për menaxhimin e projekteve në ndërmarrje		
	R2. Shpjegojë konceptet dhe fazat kryesore të ciklit të menaxhimit të projekteve		
	R3. Aplikojë mjete dhe teknika për planifikim, monitorim dhe vlerësim të projekteve		
	R4. Bëjë përzgjedhjen (ekipore) e projektit më të përshtatshëm për ndërmarrjen		
	R5. Posedojë vizion fillestar për krijimin e idesë për projektin në ndërmarrje		
	R6. Identifikojë platformat dhe mjetet dixhitale që mund të përmirësojnë efikasitetin e projektit		
	R7. Analizojë mënyrat se si AI mund të automatizojë faza të ndryshme të ciklit të jetës së projektit (planifikimi, risku, monitorimi, etj.)Aplikon mjete dhe teknika për planifikim, monitorim dhe vlerësim të projekteve.		
	Rezultatet e të nxënit dhe lidhja me ECTS-in:		
	Rezultati i parë dhe i dytë janë të ndërlidhura me 1.0 ECTS,		
	Rezultati i tretë është i ndërlidhur me 1.0 ECTS,		
	Rezultati i katërtë i pestë dhe gjashtë është i ndërlidhur me 1.2 ECTS,		
	Rezultati i shtatë është i ndërlidhur me 0.8 ECTS.		
	Shënime:		
	- Këto orë përfshijnë leksione, ushtrime, detyra praktike, punë kërkimore, përgatitje për prezantim ose projekt, diskutime në klasë dhe vetë-studim. - R3 ka peshë më të madhe sepse përfshin aftësi praktike të domosdoshme për menaxhimin e suksesshëm të projekteve. - R7 është i rëndësishëm për integrimin e teknologjive të reja si AI, që është trend aktual në menaxhimin modern të projekteve		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrimet teorike/detyra	1	15	15

Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësit – konsultimet	1	5	5
Ushtrime në terren	5	2	10
Kollokuiume – seminare			
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			20
Përgatitja përfundimtare në provim	2	5	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	2	3	6
Projektet, prezantimet etj	2	2	4
Totali			100

Metodologjia e mësimdhënies (dhe mësimnxënies)	Ligjërata prezantime, punë e pavarur në terren dhe Rast Studimi, orientimi në shpjegimin e materialit do të diskutohen në grupe, vizitë praktike grupore me student, prezantimet e studentëve për Rast Studimi, Punime seminarike / Projekte Hulumtimi.
Metodat e vlerësimit (kriteret e kalueshmërisë)	Metoda e vlerësimit – mbështetet në tri aktivitete – në bazë të të cilave do të ndërtohet nota përfundimtare: • Aktivitete dhe Angazhim në mësim max 10 pikë (%), • Hartimi dhe prezantimi i projektit/punim seminarik max 30 pikë (%), • Provimi final max 60 pikë (%), Kriteret e kalueshmërisë nderlidhur me aktivitetet e parapara me metodën e vlerësimit: 1. Aktiviteti dhe Angazhimi në mësim – vlerësohet me 10 pikë (%) nga 100 pikët (%) e mundshme: • Aktiviteti në mësim (5 pikë) - nënkupton që studenti të jetë aktive dhe i përfshirë në diskutime interaktive profesor-studentë, studentë-studentë, duke hapur tema të reja që janë të ndërlidhura me lëndën, duke dhënë ide, opinione, mendime kritike me qëllim të nxitjes së debatit gjatë ligjëratave. • Angazhimi (5 pikë) - nënkupton që studenti të kryejë dhe prezantoj detyrat që caktohen në fund të secilës ligjëratë dhe pastaj diskutohen në fillim të ligjëratës vijuese. Qëllimi: Nxitja e mendimit kritik dhe zgjidhja kreative e situatave reale ndërlidhur me problemet e parashtruara - të ndërlidhura me mësim-nxënien në modulin e lëndës. 2. Hartimi dhe prezantimi i një projekti/punimi seminarik - vlerësohet me 30 pikë nga 100 pikët (%) e mundshme, Brenda semestrit studenti (mund të jetë një grup i studentëve – jo më shumë se 2 studentë) duhet të përgatitë një projekt/punim seminarik (Word dhe në PowerPoint), i njëjti punim duhet të prezantohet gjatë orëve të caktuara për prezantim. Prezantimi do të zgjasë më së shumti 15 minuta. Tema e punimit mund të propozohet nga profesori dhe nga studenti – tema e propozuar nga studenti duhet të miratohet nga

profesori, dhe e njëjta duhet të jetë në korrelacion të plot me lëndën.

Punimi prezantohet para grupit dhe vlerësohet në bazë të cilësisë së përmbajtjes, analizës, kreativitetit dhe aftësisë për ta prezantuar qartë.

Kriteret e vlerësimit të projektit/punimit seminari	
Komponenti	Pikët (%)
Struktura dhe Qëllimi i punimit	10
Përmbajtja/shtjellimi i punimit	10
Përfundimet e nxjerra dhe prezantimi i punimit	10
Gjithsej:	30 pikë

Qëllimi: zhvillimi i aftësive kërkimore, analitike dhe shkencore, përmes trajtimit të një teme të caktuar në mënyrë të pavarur dhe akademike - të ndërlidhura me mësim-nxënien në modulën e lëndës Menaxhimi i Projekteve.

3. Testi i provimit final, vlerësohet me 60 pikë (%) nga 100 pikët (%) e mundshme,

Studenti ka të drejt ti nënshtrohet provimit final - me gojë ose me shkrim. Studenti do t'i nënshtrohet testit të provimit final, pas përfundimit të ligjëratave të lëndës dhe në afatet e provimeve të përcaktuar nga senati i Universitetit.

Qëllimi i provimit është që të vlerësohet njohuria, aftësia, shkathtësia dhe kompetencat e studentit, ndërlidhur me rezultatet e mësim-nxënies të parapara në materialin e lëndës së ligjësuar.

Testi i provimit (formulari me pyetje) duhet të plotësohet në mënyrë individuale nga studentit dhe i njëjti vlerësohet sipas kriterëve dhe përmban:

- ♦ pyetje objektive me zgjedhje të shumëfishta alternative, të njëjtat do të shfrytëzohen për të vlerësuar aftësitë e studentit për të ri- kujtuar dhe njohur konceptet dhe materialin e lëndës **30 pikë (%)**
- ♦ pyetje subjektive të llojit tema për shpjegim/përgjigje me shkrim/detyra - për të cilat vet studentit duhet të jete në gjendje të jep përgjigje ndërlidhur me materialin e lëndës së ligjësuar, të njëjtat përgjigje do të shfrytëzohen për të vlerësuar të kuptuarit dhe aftësitë e studentit për të zbatuar njohuritë e fituara në analizë, sintezë/vlerësim të problemit **30 pikë (%)**

Qëllimi i testit: të vlerësojë përvetësimin e rezultateve të mësim-nxënies dhe aftësinë për t'i zbatuar ato në situata praktike

Studenti e kalon provimin nëse grumbullon 50 pikë (%) nga të gjitha aktivitetet e parapara me metodën e vlerësimit,

Notat në UShAF:

Nota	ECTS/Nota	Përqindja (%)	Përkufizimi
10	A	90 - 100	Shkëlqyeshëm
9	B	80 - 89	Shkëlqyeshëm
8	C	70 - 79	Shumë mirë
7	D	60 - 69	Mirë

		6	E	50 - 59	Mjaftueshëm
		5	FX/F	0 - 49	Pamjaftueshëm
Mjetet e konkretizimit – TI	Përdorimi i tabelës, Interneti, wireless, kompjuteri, projektori, PowerPoint, Përdorimi i platformave dhe mjeteve online për të mbështetur komunikimin dhe bashkëpunimin në ekip, etj.				
Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit	60% teori (75 orë) – 40% praktikë (50 orë) Ky raport ka për qëllim të analizojë lidhjen ndërmjet njohurive teorike të përfituara gjatë ligjëratave në lëndën 'Menaxhimi i Projekteve' dhe aplikimit të tyre në aspektin praktik. Përmes këtij studimi synohet që studentët të fitojnë një kuptim më të qartë se si menaxhohen projektet në jetën reale, duke përdorur mjete dhe metoda të standardizuara. Nga gjithsej 125 orë të parapara për lëndën, ndarja është bërë sipas raportit 60% teori (75 orë) – 40% praktikë (50 orë) • 60% teori (75 orë) janë të dedikuara për ligjërata teorike, përfshirë përvetësimin e koncepteve bazë, metodologjive dhe standardeve të 'Menaxhimi i Projekteve'. • 40% praktikë (50 orë) janë të fokusuara në ushtrime praktike, analiza rastesh konkrete, punë në grup dhe zhvillim projektsh simulimi. • Ndarja e ECTS sipas raportit 60% teori (75 orë) – 40% praktikë (50 orë) Lënda 'Menaxhimi i Projekteve'vlerësohet me 4 ECTS, nga të cilat: - 2.4 ECTS (60%) i dedikohen pjesës teorike. - 1.6 ECTS (40%) i dedikohen pjesës praktike. Kjo ndarje reflekton balancën ndërmjet përvetësimit të koncepteve bazë dhe zbatimit të tyre përmes aktiviteteve praktike.				
Literatura					
Literatura bazë	1. Panariti S. - „Menaxhimi i Projekteve“, 2017 Tiranë,				
Literatura shtesë	1. M. Mustafa – “Menaxhimi i projekteve dhe investimeve”, Riinvest 2008, 2. Digital Project Management: The Complete Step By Step Guide to a Successful Launch 3. Applying Artificial Intelligence in Project Management (MLI Generative AI Series)" Paul Boudreau 4. *Krasniqi, S. (2021). Roli i projekteve në zbatimin e strategjisë së zhvillimit të Kosovës. ISBN: 978-9951-28-046-4. Prishtinë: Botimi Artini				
*Informacione shtesë	Përmbajtja e lëndës është përditësuar për të reflektuar kontributet e punimit shkencor: Krasniqi, S. (2021). Roli i projekteve në zbatimin e strategjisë së zhvillimit të Kosovës. ISBN: 978-9951-28-046-4. Prishtinë: Botimi Artini				
Përditësimi i përmbajtjes me bazë kërkimore	Ky punim është integruar në temën: Strategjia e organizatës & Zgjedhja e Projektit Nga kjo punë kërkimore janë integruar				

	elemente kyçe në përmbajtjen e lëndës si: • Projekti si instrument për zbatimin e strategjive zhvillimore – diskutuar në temën <i>Strategjia e organizatës & Zgjedhja e Projektit</i>, duke analizuar se si projektet ndihmojnë në realizimin e dokumenteve strategjike të zhvillimit në nivel lokal dhe kombëtar. • Menaxhimi i projekteve publike dhe ndërinstitucionale – theksim i sfidave të koordinimit dhe të kapaciteteve menaxheriale në institucionet publike. • Koordinimi institucional dhe financimi i projekteve – reflektuar në temat që trajtojnë burimet e financimit dhe qeverisjen ndërinstitucionale në zbatimin e projekteve publike dhe zhvillimore.
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë	Prezantimi – njoftimi i studenteve me syllabusin e lëndës, Roli dhe kuptimi i menaxhimit të PROJEKTEVE në organizatë Përkufizimi i menaxhimit të projekteve • Çfarë është një projekt? • Çfarë kuptimi ka menaxhimi i projekteve? Rëndësia e menaxhimit të projekteve në organizatë • Pse menaxhimi i projekteve është i domosdoshëm? • Përfitimet e një menaxhimi efektiv projektësh. Elementet bazë të menaxhimit të projekteve • Qëllimet dhe objektivat e projektit • Burimet dhe kufizimet Rezultatet e Nxënies që mbështet R1,R2
Java e dytë	Përse Menaxhim i Projektit, Çfarë përfaqëson projekti, Çfarë përfaqëson projekti, A dallon një projekt publik nga ai privat? Tri kushtëzimet e projektit, Cikli i jetës së projektit, Diferencimi i llojeve të projekteve, Rëndësia e menaxhimit të projektit, Menaxhimi i projektit në sektorin publik, Përcaktuesit e suksesit të projektit Rolet në një projekt • Roli në nivel ekzekutiv në projekt • Roli në nivel menaxhimi në projekt • Roli në nivel përfaqësimi në projekt Portofoli, programet, Projektet dhe nënprojektet, Kërkesa të veçanta në menaxhimin e projektit Rezultatet e Nxënies që mbështet R1,R2
Java e tretë	*Tema e ligjërates nga Punimi Shkencorë: Roli i projekteve në zbatimin e strategjisë së zhvillimit të Kosovës Strategjia e organizatës & Zgjedhja e Projektit Proçesi i menaxhimit strategjik, Nevoja e menaxhimit efektiv të portofolit të projekteve Vlerësimi i opsioneve për zgjedhjen e projektit 1. Modelet jo numerike 2. Analiza financiare

	3. Kriteret jo financiare Analiza ekonomike për projektet publike, Proçesi i portofolit të projekteve, Marrja e Vendimit dhe prioritarizimi, Nivelet dhe hapat në Menaxhimin e Portofolit të Projekteve, Faktorët kryesorë për menaxhimin e suksesshëm të portofolit të projekteve dhe problemet në zbatimin e tij, Propozimi i projektit Rezultatet e Nxënies që mbështet R2,R4
Java e katërt	Struktura e organizimit të projektit, Definimi i projektit: pasqyrimi i përgjithshëm i projektit, Cili është problemi/mundësia, Kush është përgjegjës për projekt? Kur duhet të përfundojë projekti? Identifikimi i synimeve të projektit, Rëndësia e objektivave, Cilat kritere do të përdoren për të vlerësuar suksesin e projektit? Rezultatet e Nxënies që mbështet R2,R4
Java e pestë	Planifikimi kohor i projektit, Rëndësia e planifikimit të projektit Proceset në menaxhimin e kohës në projekte, Tre lloje të varshmërive, Rrjedhja/Renditja e Aktiviteteve, Diagramet Rrjetore, Rruga e aktiviteteve kritike, Metoda e Rrugës Kritike - Critical Path Method (CPM), Metoda PERT, Zhvillimi i Planifikimit, Ndërtimi i Diagramit të Gantt-it Rezultatet e Nxënies që mbështet R2,R3
Java e gjashtë	Planifikimi i projektit, Llojet e planeve, Udhëheqja me resurset njerëzore, Menaxhimi me raportet ndërnjerëzore në projekt, Udhëheqja me projektin, Kontrolli i projektit, Aspektet tjera të menaxhmentit të projektit, Lokacioni i projektit, Mjetet kryesore të projektit, Realizimi i projektit Rezultatet e Nxënies që mbështet R2,R3,R5
Java e shtatë	Marketingu i Projektit • Çmimi i produkteve/shërbimeve të projekteve • Shitja e produkteve/shërbimeve të projektit • Distribucioni i produkteve të projektit • Promocioni i produkteve të projektit • Dizajnimi i projektit • Dizajneri dhe projekti Rezultatet e Nxënies që mbështet R1,R5
Java e tetë	Menaxheri i projektit, kërkesat dhe aftësitë speciale për menaxherin e projektit Menaxheri funksional kundrejt menaxherit të projektit, Përgjegjësia e projektit, Ngritja e grupeve dhe motivimi, Menaxheri i projektit, Komunikimi & Mbledhjet, Aftësitë e menaxherit të projektit, Aftësitë menaxheriale të Menaxherit të Projektit, Menaxhimi i ndryshimit Rezultatet e Nxënies që mbështet R1,R2
Java e nëntë	Menaxhimi i konfliktit & negociimit Ambienti i konfliktit, Burimet dhe kategoritë e konfliktit, Mënyra e zgjidhjes të konfliktit, Kërkesat dhe parimet e negociimit, Konflikti dhe cikli i jetës së projektit, Zgjidhja e problemit Rezultatet e Nxënies që mbështet R4
Java e dhjetë	Vlerësimi i kostos & Proçesi i buxhetimit Faktorët që ndikojnë

	në strukturën e buxhetit, Faktorët që ndikojnë në strukturën e buxhetit, Llojet e kostos së projektit, Vlerësimi i Buxhetit të Projektit, Raportimi financiar i rezultateve të projektit, Rezultatet e Nxënies që mbështet R3
Java e njëmbëdhjetë	Burimet e financimit të projektit Obligimet ndaj burimeve të huaja financiare, Format e burimeve vetjake, Këshillat lidhur me burimet e kapitalit për nxitjen e projektit, Kushtet kreditore të bankave, Rezultatet e Nxënies që mbështet R3
Java e dymbëdhjetë	Pregaditja/Hartimi i Projekt Propozimit Elementet kryesore të një Projekt Propozimi, Përcaktimi i nevojave për personel – Menaxheri i Projektit, Përcaktimi i detyrave, Kontrolli dhe Monitorimi Rezultatet e Nxënies që mbështet R3,R4,R5
Java e trembëdhjetë	Monitorimi dhe kontrolli i projekteve Monitorimi i Projekteve, Llojet e raporteve, Kontrolli i performances, Kontrolli i kostos, Qëllimet kryesore të Kontrollit, Përfundimi i projektit, Llojet e mbylljes së projektit, Procesi i mbylljes së projektit Rezultatet e Nxënies që mbështet R3
Java e katërbëdhjetë	Menaxhimi i projekteve në transformimin e epokës dixhitale Kuptimi i Transformimit Dixhital, roli në zhvillim i menaxherit të projektit, Përfitimet kryesore të Transformimit Dixhital në menaxhimin e projektit, Sfidat e menaxhimit të projektit në epokën dixhitale, adoptimi i proceseve të menaxhimit të projekteve, ndërtimi i kompetencave dixhitale në menaxhimin e projektit, e ardhmja e menaxhimit të projektit në epokën dixhitale Rezultatet e Nxënies që mbështet R1,R6
Java e pesëmbëdhjetë	Roli i Inteligjencës Artificiale në Automatizimin e Proceseve të Projekteve • Çfarë është IA dhe si lidhet me menaxhimin e projekteve • Automatizimi i detyrave: planifikimi i orareve, përlllogaritja e burimeve, analiza e rrezeve • Softuerë të zakonshëm: Monday.com, ClickUp, Asana me IA, Microsoft Project + Copilot • Raste studimore: Përdorimi i IA për parashikimin e vonësve në projekte ndërtimi Rezultatet e Nxënies që mbështet R3,R6,R7
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes	
Gjatë orëve të leksioneve dhe ushtrimeve, NDALOHET ngrënia, pëshpëritja që pengon punën në klasë dhe përdorimi i celularëve. Në të njëjtën kohë, telefonat celularë duhet të fiken ose të vihen në heshtje dhe të mos përdoren gjatë leksioneve ose ushtrimeve. Mungesa e integritetit akademik (përfshirë plagjiaturën, kopjimin e punës së një personi tjetër, përdorimin e mjeteve ndihmëse të paautorizuara të provimit, mashtrimin, etj.) nuk do të tolerohet. Nëse ka dyshime për vërtetësinë e punimit të paraqitur, mësuesi ka të drejtë t'i kërkojë nxënësit të verifikojë punën e tij. Kjo mund të bëhet përmes: përsëritjes së punës, testimit me shkrim ose me gojë, kuizit të papritur ose çdo veprimi tjetër që gjykohet i nevojshëm nga pedagogu.	